

CONTACTS

Përmbledhimi i aksesibilitetit për pasagjerët me aftësi të kufizuara.

Krijimi dhe shpërndarja e një faqe Web-i me informacion nga përfitimet e aktivitetit turistik në Qarkun e Durrësit si dhe promovimi i politikave lehtësuese për anijet cruiser.

Nxjta e përdorimit të mjeteve me emetim të ulët karboni në terminalin e pasagjerëve si ngjitja e një shërbimi e-bicikletash me qera, shërbimi të autobusit elektrik, zgjerimi të shërbimit E-taxi.

Krijimi i pikave turistike të informacionit përgjatë të gjitha rrugëve turistike brenda qytetit dhe zhvillimi i një aplikacioni për turistët në të gjitha pikat atraktive dhe aktivitetet.

Riorganizimi i skemës së transportit në hyrje të portit dhe në terminalin e pasagjerëve, vendosja e sinjaleve horizontale për secilin rrugë (daljet nga porti).



LOCATIONS



Promovimi i transportit të pastër në qytetet e destinacionit të krocerave

Situata aktuale në qytetin e Durrësit.

Porti i Durrësit është porti më i madh i Shqipërise dhe tashmë i përcaktuar si porta kryesore e korridorit VIII. Një nga investimet kryesore në port është ndërtimi i terminalit të pasagjerëve. Më tepër se 800,000 pasagjerë, nga të cilët 2% janë turistë të përditshëm, kalojnë terminalin çdo vit. Turistët përdorin anijet cruiser, anijet turistike dhe linjat e rregullta të trageteve. Ata zakonisht lëvizin në zonat me interes të qytetit ose marrin autobusin për në qytetin e Krujës si destinacioni më i afërt turistik.

Siguria dhe parrezikshmëria e lëvizjes së turistëve janë me cilësi të lartë. Ekzistojnë shërbimet e mobilitetit dhe të informacionit (informacion turistik).

Por mungojnë Udhëtime të organizuara për turistët, informacion në kohë reale për transportin publik, platformë për shërbime informacioni në kohë reale, biletë e integruar (transport urban ose interurban)

Pasojat e lëvizjes së turistëve në qytet: Trafik i rënduar në portin e Durrësit dhe hyrjet e qytetit, mbingarkesë rrugore në dalje të portit, mbipopullim në zonat e vjetra historike, mungesë e pikave të parkimit në zonat turistike, përdorim të ulët të transportit publik.



Analiza e fluksit të pasagjerëve me kroçera



Përfshirja e grupeve të interesit



Identifikim i burimeve të mundshme për financim



Përcaktimi prioriteteve



Zhvillimi i masave



Zhvillimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit

Implementimi i projektit LCTP.

Implementimi i projektit LCTP do të tërheqë më shumë turistë nga anijet turistike për të vizituar Durrësin dhe zonat e afërta të interesit. Do të përmirësojë shërbimet e lidhura me pasagjerët e anijeve cruiser. Do të rrisë vizitat turistike në monumentet dhe zonat historike të rajonit të Durrësit. Do të përmirësojë transportin publik dhe sistemin e informacionit. Do të përmirësohet lëvizshmëria dhe cilësia e vizitave për turistët dhe qytetarët e Durrësit dhe të zonave për rreth. Do të reduktohet trafiku në

portin e Durrësit dhe rrugët e daljes nga porti. Do të reduktohet emetimi i GHG nëpërmjet rritjes së përdorimit të mënyrave të transportit më miqësore me mjedisin. Do të reduktohet mbipopullimi nga vizitorët i zonave historike të rajonit të Durrësit. Do të rriten të ardhurat e zonës nga aktivitetet turistike.

CO₂
Reduktimi i

rreth 619 kg CO₂/pasagjer



LËVIZSHMËRIA E QËNDRUESHME

